Kronikë

# Fqinji qëllon me armë çiftin në Rrogozhinë, policia me kallashnikov 'kreh' zonën, dorëzohet autori! Gjendet dhe pistoleta e krimit (EMRAT+VIDEO)

*Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e kësaj të premteje në fshatin Gosë të Rrogozhinës, ku një konflikt mes fqinjësh ka përfunduar në përdorimin e armëve. Policia arreston autorin dhe gjen armën e krimit pistoletë të fshehur në një mur. pranë saj edhe një 'shuk' me lekë*

■ Kavajë/ Plagosi çiftin e bashkëshortërve pas sherrit për lehjet e qenit, Policia gjen pistoletën e autorit të fshehur në mur! Pranë saj dhe 'shuku' me lekë

■ Plagosja në Rrogozhinë, zbardhet dëshmia e autorit: Qeni i tyre më shqetësonte, atë doja të vrisja

Lajmi i fundit

Kolumbi/ Kandidati presidencial qëllohet në kokë gjatë një tubimi

8 Qershor, 08:51

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
6 Qershor, 11:16 | Përditësimi: 6 Qershor, 20:03

Share

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e kësaj të premteje në fshatin Gosë të Rrogozhinës, ku një konflikt mes fqinjësh ka përfunduar në përdorimin e armëve.

Shqëtësim Osma ka qëlluar me armë zjarri dy bashkëshortët Sami dhe Nadire Disha, duke i plagosur njërin në këmbë e tjetrin në bark.

Fatmirësisht çifti i bashkëshortëve ndodhen jashtë rrezikut për jetën, ndërsa autori është ende në kërkim.

LEXO EDHE:
**Tiranë/ Konflikt mes komshinjve në Allias, plagoset me armë në këmbë 31-vjeçari! Shpallet në kërkim autori (EMRAT+VIDEO)**

Pas ndjekjes së policisë, bëhet me dije se autori është vetëdorëzuar. Në dëshminë e dhënë bëhet me dije se Shqëtim Osma ka thënë se qëllimi i tij ishte të vriste qenin e tyre, sepse se bezdiste.

Pasditen e sotme Policia e Kavajës bëri me dije se ka gjetur pas kërkimeve në Gosë edhe armën e krimit tip pistoletë, që dyshohet se është përdorur nga autori, që u sekuestrua si provë materiale. Pranë armës u zbulua edhe një 'shuk' me lekë, që mendohet se autori do i përdorte dhe do e ndihmonin gjatë arratisjes.

> *"Në fshatin Gos, Rrogozhinë, mëth orës 10.15, dyshohet se si pasojë e një konflikti për motive të dobëta shtetasi Sh. O. ka plagosur me armë zjarri, pistoletë jashtë rrezikut për jetën shtetasit S. D., dhe N.D (autori komshi me çiftin që plagosi). Me marrjen e njoftimit, shërbimet e Policisë kanë shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes, kanë rrethuar zonën dhe vendin ku dyshohet se është fshehur autori.*
>
> *Në ndërhmë të Policisë lokale kanë shkuar forcat operacionale të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dhe vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e autorit", informoi sot policia, pak caste pas krimit të ndodhur.*

Më pas u konfirmua edhe lokalizimi dhe prangosja e të dyshuarit Osma dhe gjetja e pistoletës. Kurse grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për zbardhjen dhe dokumentin ligjor të ngjarjes.

Rendit zhvillimet sipas orarit: TË FUNDIT

**Ora 19:44**

## Kavajë/ Plagosi çiftin e bashkëshortëve pas sherrit për lehjet e qenit, Policia gjen pistoletën e autorit të fshehur në mur! Pranë saj dhe 'shuku' me lekë

Pistoleta e përdorur për plagosjen e çiftit në Gosë

Pak orë pas krimit të dyfishtë të ndodhur në Gosë të Rrogozhinës ditën e sotme, Policia e Kavajës ka arritur që të gjejë edhe armën e krimit të përdorur nga autori i dyshuar, i cili gjithashtu u arrestua.

Sherri mes fqinjëve sot përfundoi me veprimin e Shpëtim Osmës, i cili ka qëlluar me armë zjarri dy bashkëshortët Sami dhe Nadire Disha, duke i plagosur njërin në këmbë e tjetrin në bark.

Pak pas arrestimit të tij, policia vendore konfirmoi se gjeti të fshehur në një mur pistoletën që dyshohet se përdori Osma. Një tjetër detaj interesant ka qenë se pranë saj u zbulua edhe një "shuk" me lekë të lëna nga autori, ndoshta për t'i përdorur gjatë arratisjes. Paraë ishin kartmonedha të prerjeve të ndryshme, 50 mijë lekëshe (të njetra), 20 mijë lekëshe dhe 10 mijë lekëshe, të futura në një qese të vogël.

> *"Në vijim të veprimeve për dokumentimin ligjor të ngjarjes së ndodhur në fshatin Gos, shërbimet e Policisë gjetën të fshehur në një mur dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale armën e zjarrit tip pistoletë, me të cilën dyshohet se autori ka plagosur shtetasit S.D dhe N.D. Po në vijim të veprimeve specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Durrës, arrestuan në flagrancë shtetsin Sh. O., 56 vjeç, pasi ky shtetas dyshohet se plagosi me armë zjarri dy komshinjtë e tij gjatë një konflikti për motive të dobëta", bëri me dije policia vendore.*

Veprimet procedurale për këtë ngjarje i kanë kaluar Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Krimi i sotëm dyshohet se ka ndodhur për shkak të lehjeve të vazhdueshme të qenit të çiftit të plagosur dhe këtë pretendim ka dhënë i arrestuari Osma pak caste pas prangosjes, kur është pyetur për motivet.

A.Q/Shqiptarja.com

Share

**Ora 13:56**

## Plagosja në Rrogozhinë, zbardhet dëshmia e autorit: Qeni i tyre më shqetësonte, atë doja të vrisja

FOTO: Shqëtim Osma

Është zbardhur dëshmia e autorit i cili plagosi çiftin e bashkëshortëve Gosë, Rrogozhinë.

Shqëtim Osma ka deklaruar në polici se ka pasur konflikte të vazhdueshme me familjen Disha pasi qeni i tyre i linte pa gjumë dhe vetëm lehte.

Sipas tij kishte kërkuar disa herë të merrnin masa për këtë shqetësim që i shkaktonte qeni.

Pasi familja Disha nuk e ka hequr qenin siç kishte kërkuar autori kanë debatuar.

Osma ka marrë armën për të qëlluar drejt qenit, por plumbat kapën dy bashkëshortët.

Xh.K/A.Q/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Rrogozhinë Sami Disha Nadire Disha plagosja me armë zjarri Shpëtim Osma Tiranë

Komento

Komente

Ndalohet reprodhimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

**Sondazhi i ditës:** 7 Qershor, 22:45
**Shqipëria barazoi me Serbinë, sa shanse ka për të shkuar në Botëror?**

Shumë Pak Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Tiranë/ Ndërron jetën 14-vjeçari, ra aksidentalisht nga kati i 5-të i një pallati në Vëzherisht
7 Qershor, 20:23

E PLOTË/ Kryeministri Rama në Festivalin e Arkitekturës 'Bukë e zemër': Shqipëria sot prodhon më shumë arkitekturë sesa e gjithë Europa bashkë

Edi Rama
7 Qershor, 19:58

Martin Leka: Goli që duhet t'i bëjmë Serbisë dhe urë 'antishqiptari' që mendoj se lojtarët serbë edhe mund të na mundin

Martin Leka
7 Qershor, 18:23

Veliaj mesazh kombëtares para ndeshjes Shqipëri-Serbi: Na bëini krenarë
7 Qershor, 17:42

Stërvitja 'Defender 2025' zbarkon në Bizë, FA dhe FSK demostrojnë gjuajtje me mortajë më shumë se 2 km

Sokol Dema
7 Qershor, 17:21

Shqipëri-Serbi/ 6 orë festë në Tiranë, 'vullkani' kuqezi 'ndez' kryeqytetin me kënge dhe valle popullore (VIDEO)
7 Qershor, 16:15

Botërori 2026/ Rey Manaj s'bëhet dot 'mbret', gabon penalltinë në 'Arenën Kombëtare'! Shqipëria barazon 0-0 kundër Serbisë në Tiranë

Stavro Dhimitri
7 Qershor, 15:44

Tiranë/ Gjendet një person i vdekur në rrugën 'Njazi Meka', dyshimet e para
7 Qershor, 15:22

Tifozi me 'fytyrën flamur' bën parashikimin: 3-1 për Shqipërinë! Detajet në veshẗjen e tij që tërheqin vëmendjen (VIDEO)
7 Qershor, 14:15

Rinas/ Tentoi të dilte nga Shqipëria me 194 mijë euro të padeklaruara, vihet nën hetim 45-vjeçari izraelit
7 Qershor, 12:54

Tiranë/ Nën shoqërinë e njëri-tjetrit dhe kokainës, arrestohet çifti në kryeqytet
7 Qershor, 11:52

Tiranë/ Qeni kafshon fëmijën 5-vjecar, vogëlushi përfundon në spitalë! Policia merr nën hetim pronarin e kafshës
7 Qershor, 11:38